

STATUT

I

SHOQËRISË "AIC COMPANY" Sh.p.k.

KREU I

KRIJIMI, FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI SELIA, DHE KOHEZGJATJA E SHOQERISE.

Shoqëria me përgjegjësi te kufizuar " AIC COMPANY" Sh.p.k. me qendër :Rr."Sami Frashëri", Pall. TID, Shkalla F, kati i II-të, Z. 10, Tiranë , është krijuar sipas kontratës që i bashkëlidhet ky statut i përpiluar dhe nënshkruar nga :

Z.Ylli Zyla, i biri i Xhafer-it, me datëlindje 25.04.1970, lindur në Tepelenë dhe banues në Tiranë shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit elektëk me nr 024741411 dhe me nr personal H00425281M.

Znjsh. Arba Zyla, e bija e Yllit, me datëlindje 16.03.1995, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, shtetase shqiptare, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit elektëk me nr 032059507 dhe me nr personal J55316059N.

Z. Ron Meloka, i biri Yaacov, me datëlindje 28.10.1961, lindur në Izrael, dhe banues në Izrael, shtetas izraelite, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet pasaportës me nr 10939244, **i përfaqësuar me prokurë lëshuar më datë 30.03.2016, nga Z.Ylli Zyla (bashkangjitur prokura).**

Znj. Haya Meluka, e bija e Moshe, me datëlindje 13.12.1960, lindur në Izrael, dhe banues në Izrael, shtetase izraelite, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet pasaportës me nr20984017. **i përfaqësuar me prokurë lëshuar më datë 30.03.2016, nga Z.Ylli Zyla (bashkangjitur prokura).**

Znj.Netta Aylon, e bija e Michael, me datëlindje 14.02.1975, lindur në Izrael, dhe banuese në Izrael, shtetase izraelite, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet pasaportës me nr. 13164423 **i përfaqësuar me prokurë lëshuar më datë 30.03.2016, nga Z.Ylli Zyla (bashkangjitur prokura).**

Z. Michael Ayalon, i biri i Haim, me datëlindje 12.10.1945, lindur në Morocco, dhe banues në Izrael, shtetas izraelite, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet pasaportës me nr 22372594, **i përfaqësuar me prokurë lëshuar më datë 31.03.2016, nga Z.Ylli Zyla (bashkangjitur prokura).**

Hartojmë këtë statut te shoqërisë " AIC COMPANY " Sh.p.k, mbështetur ne ligjin 9901 date 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ligjin 9723 date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit", Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, si me poshtë:

Neni 1

Krijimi

Shoqëria e fiton personalitetin juridik nga dita e regjistrimit te saj.

Emërtimi i shoqërisë është " AIC COMPANY" Sh.p.k

Kjo shoqëri është person juridik i te drejtës shqiptare. Shoqëri me përgjegjësi te kufizuar (me poshtë e quajtur "Shoqëria").

Të dhënat personale mbrohen

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria "AIC COMPANY" Sh.p.k, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga "ortakët e shoqërisë", të cilët përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë. Parashikime të tilla vlejne vetem dhe vetem për detyrimet që rrjedhin në emër të shoqërisë nga ortakët në periudhën pas nxjerrjes së NIPT-it, nga QKR. Mbas nxjerrjes së NIPT-it cdolloj detyrimi që rrjedh në emër dhe për llogari të shoqërisë do të jetë i pagueshem nga shoqëria nga kapitali i saj, duke qenë se ka kapitalin e saj.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë në Rr. Rr. "Bulevardi Deshmoret e Kombit", Kulla e dytë, nr pasuire 3/329+2-N30, Zona kadastrale 8270, volum 29, faqe 45, Tiranë.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e tij, të hapë zyra përfaqësie, dege, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Fusha e veprimtarisë së shoqërisë do të jenë:

- **Agrikulturë (inputet, njohuri, zhvillimi rural, menaxhim projektsh etj)**
- **agrobiznesi**
- **tregëtimi**
- **infrastruktura**
- **gërmimi dhe mineralet**

Shoqëria do të merret me Eksport-Import dhe tregtim me shumice dhe pakice të të gjithë llojeve të materialeve e pajisjeve të ndertimit, të mallrave të ndryshme industrial e ushqimore dhe mallrave të të gjitha llojeve. Të ushtroje veprimtarinë e ndermjetesimit apo të lidhjes së kontratave ndermjet personave fizik apo juridik, publik, shtetëror e privat vendas e të huaj. Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera që kanë objekt të ngjashëm me të. Për kryerjen e veprimtarisë së saj shoqëria do të hapë njësi menaxhuese, magazinuese, shërbim tregtimi, duke bashkëpunuar me persona fizik e juridik vendas dhe të huaj. Shoqëria do të kryejë të gjitha llojet e aktiviteteve tregtare me qëllim realizimin e veprimtarive të përkrahura me siper. Shoqëria do të kryejë Investime për prodhimin, grumbullimin, përpunimin, ambalazhimin, ruajtjen dhe tregtimin për vend e eksport të produkteve bujqësore e blektorale, do bëjë transport të mallrave e pasagjerëve, do kryejë investime në pasuritë e palujtshme, kryesisht për toka e ndertesa në funksion edhe të aktiviteteve të tjera, etj. Ortakët e Shoqërisë kanë të drejtë të marrin vendim për të shtuar objektin e veprimtarisë së shoqërisë ”

Neni 5

Kobëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të paktën 15 vjet.

KREU II
KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jete: 10.800 lekë (dhjetë mijë e tetëqind Lekë) e përbërë nga gjashtë kuota dhe zotërohet nga ortakët e saj si më poshte:

- | | |
|------------------|-----------------------------------|
| 1. Ylli Zyla | me 24 % te kuotave = (2592 leke) |
| 2. Arba Zyla | me 9% të kuotave = (972 lekë) |
| 3. Ron Meloka | me 20 % te kuotave = (2160 lekë) |
| 4.Haya Meluka | me 13 % të kuotave = (1404 lekë) |
| 5. Netta Aylon | me 17 % të kuotave = (1836 lekë) |
| 6.Michael Ayalon | me 17 % të kuotave = (1836 lekë) |

Çdo kuote i takon e drejta e një vote.

Te gjitha pjesët e kapitalit themeltar janë nënshkruar e shlyer krejtësisht.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund to përfaqësohen nga letra me vlere te tregtueshme. Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre(pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta).

Ortaku, qe pengohet te ushtroje te drejtat qe i rrjedhin nga zotërimi i kuotës se shoqërisë, ka te drejte t'i kërkojë gjykatës to urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e demit te shkaktuar, si pasoje e cenimit te këtyre te drejtave. Kjo e drejte parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund te zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve te pjesëve te kapitalit themeltar për kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës se administratorit.

Ne asnjë rast shumica nuk mund te detyroje një ortak për te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njëjtat kushte qe kërkohen për ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogëlimi prek ortakët ne te njëjtën mase ndaj pjesëve te kapitalit qe p e r f a q e s o j n e .

Vendimi për ndryshimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare te Rregjistrimit për regjistrim nga administratori, ne përputhje me nenin 43 to ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit".

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te një shoqërie me përgjegjësi te kufizuar mund te fitohen apo kalohen nëpërmjet:

shitblerjes;

trashëgimisë;

d) dhurimit;

e) çdo mënyre tjetër te parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave te trefteve jashtë shoqërisë, me miratimin e

Të dhënat personale mbrohen

shoqërisë dhe te drejtën e parablerjes ne favor te shoqërisë apo te ortakeve te tjerë, sipas modaliteteve dhe shumicës se cilësuar qe kërkon ndryshimi i statutit.

Personi qe kalon kuotën dhe ai qe e fiton atë përgjigjen ne mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet qe rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit te kuotave, deri ne çastin e regjistrimit te kalimit te saj ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit, sipas nenit 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht te transferueshme ndërmjet ortakeve, me të drejtën e parablerjes së ortakëve të tjerë.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht te transferueshme me rruge trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organet drejtuese te shoqërisë jane:

- Asambleja e ortakeve.(Ylli Zyla, Arba Zyla, Ron Meloka, Haya Meluka, Netta Aylon, Av.Michael Ayalon).
- Bordi drejtues (Ylli Zyla, Ron Meloka dhe Michael Ayalon), i zgjedhur nga të gjithë ortakët e shoqërisë.
- Administratori (Ylli Zyla)
- Këshilluesi dhe menaxher projektsh. (Michael Ayalon)
- Marketing (Ron Meloka)
- Llogaritari (punonjës të tjerë), do të punësohen nga administratori.

Procedura për emërimin ne funksionet përkatëse dhe shkarkimin e tyre rregullohen sipas statutit te shoqërisë.

Neni 10


Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Bordit Drejtues

Bordi Drejtues thirret nëpërmjet një njoftimi me shkrese ose me njoftim nëpërmjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet te gjithë ortakeve, jo me vone se 7 dite përpara datës se parashikuar për mbledhjen e bordit. Në rast se njëri nga anëtarët e bordit drejtues nuk është i pranishëm në mbledhje, dy të tjerët kanë të drejtë të marrin vendime, vetëm me dhënien e pëlqimit me shkrim nga anëtari i bordit në mungesë.

Neni 11

Kuorumi

Bordi Drejtues thirret nëpërmjet një njoftimi me shkrese ose me njoftim nëpërmjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet te gjithë ortakeve, jo me vone se 7 dite përpara datës se parashikuar për mbledhjen e bordit. Në rast se njëri nga anëtarët e bordit drejtues nuk është i pranishëm në mbledhje, dy të tjerët kanë të drejtë të marrin vendime, vetëm me dhënien e pëlqimit me shkrim nga anëtari i bordit në mungesë.



Neni 12

Marrja e vendimeve

Bordi i Drejtuesve për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, miratimin e bilancit, kontrollin e llogarive, miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë, riorganizimin, bashkimin ose ndarjen e shoqërisë, shndërrimin në një formë tjetër, transferimin e kuotave, emërimin e eksperteve dhe likuidatorëve dhe prishjen e shoqërisë, zhvillon mbledhje të jashtëzakonshme, të cilat janë të vlefshme, nëse janë miratuar nga ortaket e saj sipas dispozitave të Ligjit Për Shoqëritë Tregtare.

Në rast mosmarrëveshesh do të thirret një ndërmjetësi licënsuar për të bërë ndërmjetësimin për zgjidhjen e tyre.

Neni 13

Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga një administrator.

Administrator i shoqërisë është **Z.Ylli Zyla**, i biri i Xhafer-it, me datëlindje 25.04.1970, lindur në Tepelenë dhe banues në Tiranë shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit elektronik me nr 024741411 dhe me nr personal H00425281M.

Neni 14

Kompetencat

Administratori ka të drejte e detyrohet te:

- a) kryeje të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësoje shoqërinë tregtare;
- c) të nënshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- e) kryeje regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- f) raportoje përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçante për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- g) Administratori ka të drejte të përfaqësoje shoqërinë përpara organeve të drejtësisë, gjykatës e prokurorisë, organeve të administratës shtetërore qendrore apo lokale, zyrës së tatimeve
- h) Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm të shoqërisë.

Neni 15

Përgjegjësitë

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare",

Të dhënat personale mbrohen

administratori detyrohet:

1. a) te kryeje detyrat e tij te përcaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirëbesim e ne interesin me te mire te shoqërisë ne tërësi, duke i kushtuar vëmendje te veçante ndikimit te veprimtarisë se shoqërisë ne mjedis;
- b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetëm për arritjen e qëllimeve te përcaktuara ne këto dispozita;
- c) te vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për te cilat merret vendim;
- d) te parandaloje dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo te mundshëm, to interesave personale me ata te shoqërisë;
- e) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave to tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne mënyrë te arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vlerësimit te informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer ne mirëbesim.

3. Nëse Administratori vepron ne kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërbleje shoqërisë dëmet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje çdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me to kane realizuar nga këto veprime te parregullta. Administratori ka barrën e provës për te vërtetuar kryerjen e detyrave te tyre ne mënyrë to rregullt e sipas standardeve te kërkuara.

4. Ne mënyrë te veçante, po pa u kufizuar ne to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërbleje shoqërisë dëmet e ,shkaktuara, nëse, ne kundërshtim me dispozitat e ligjit ,, Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakeve kontributet;
- b) u paguan ortakeve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- d) lejon qe shoqëria te vazhdoje veprimtarinë tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqëria nuk do te kishte aftësi paguese për te shlyer detyrimet;
- e) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kane te drejte to ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i është shkaktuar shoqërisë, përfshire edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme.

Asnjë vendim i asamblesë nuk mund te ndaloje ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit to detyrës.

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon nga data 1 janar dhe mbyllet me 31 dhjetor.

Përjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor 2016.

Neni 17

Bilanci i shoqërisë dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Të dhënat personale mbrohen

Mbledhja e Ortakeve vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jete zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 18

Ekspertet

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë të ngarkuar nga ana e ortakeve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohe bordit të drejtorëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 19

Te ardhurat neto që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbeten dhe i kalojnë në pronësi të ortakeve. Fitimi neto i realizuar nga shoqëria do të ndahet ndërmjet ortakëve të shoqërisë mbasi të jete likuiduar të gjitha detyrimet, dhe të jete hequr 5% që do të futet në fondin e rezervës ligjore deri në përmbushjen e 1/10 të kapitalit të shoqërisë. Kjo mënyrë shpërndarje të ardhurash do të jetë e vlefshme deri në daljen e një vendimi nga ana e Bordit Drejtues të Shoqërisë, i cili mund të sjellë ndryshime përsa i përket kësaj shpërndarje të ardhurash.

Neni 20

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;

me vendim të Bordit drejtues;

c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me piken 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Bordi Drejtues merr vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Bordi Drejtues

Nëse Bordi Drejtues nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 60 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 21

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emërimit të tij.

Të dhënat personale mbrohen

Nëse shoqëria emëron me shume se një likuidues, pervecse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njeri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimit sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit.

Neni 22

Baza Ligjore

Shoqëria do të aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit sliqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 23

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 24


Dispozita përfundimtare

Ky statut u redaktua në 7 ekzemplare me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën

shqipe, u miratua, në parim nën për nën nga Ortakët e shoqërisë tregtare "AIC COMPANY" Sh.p.k, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën origjinale.

ORTAKËT:

Ylli Zyla




Arba Zyla



Michael Ayalon



Netta Aylon




Ron Meloka



Haya Meluka



NOTERE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NOTERE REZARTA B. KOÇI

Nr. 1528 Rep.

Nr. 819 Kol.

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Në Tiranë, sot më 04.04.2016 (dymijë e gjashtëmbëdhjetë), para meje noteres publike Rezarta B. Koçi, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, me seli në rrugën “Bulevardi Zogu i Parë”, përballë “Ministrisë së Drejtësisë”, u paraqit personalisht:



PALËT:

Z.Ylli Zyla, i biri i Xhafer-it, me datëlindje 25.04.1970, lindur në Tepelenë dhe banues në Tiranë shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit elektronik me nr 024741411 dhe me nr personal H00425281M.

Znjsh. Arba Zyla, e bija e Yllit, me datëlindje 16.03.1995, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, shtetase shqiptare, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit elektronik me nr 032059507 dhe me nr personal J55316059N.

Z. Roni Meloka, i biri Yaacov, me datëlindje 28.10.1961, lindur në Izrael, dhe banues në Izrael, shtetas izraelite, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet pasaportës me nr 10939244 perfaqesuar me prokure nga **Ylli Zyla**.

Znj. Haya Meluka, e bija e Moshe, me datëlindje 13.12.1960, lindur në Izrael, dhe banues në Izrael, shtetase izraelite, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet pasaportës me nr 20984017 perfaqesuar me prokure nga **Ylli Zyla**.

Znj. Netta Aylon, e bija e Michael, me datëlindje 14.02.1975, lindur në Izrael, dhe banuese në Izrael, shtetase izraelite, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet pasaportës me nr. 13164423 perfaqesuar me prokure nga **Ylli Zyla**.

Z. Michael Ayalon i biri Haim, me datëlindje 12.10.1945, lindur në Morocco, dhe banues në Izrael, shtetas izraelite, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet pasaportës me nr 22372594 perfaqesuar me prokure nga **Ylli Zyla**.

Unë noterja vertetoj nënshkrimin e vene në dokumentin e nënshkruar nga palët e mësipërme me emërtimin “Statut i Shoqerise “AIC COMPANY” shpk.

Unë, Noterja, vërtetoj autenticitetin e nënshkrimit, në bazë të ligjit Nr. 7829, date 01.06.1994 “Për Noterinë” (i ndryshuar), si dhe në zbatim të ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (i ndryshuar), unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij vërtetimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE